




Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



Save the Children



Higjiena kibernetike

Manual për fëmijët



Hyrje

Interneti ofron një botë përvojash emocionuese për fëmijët dhe të gjithë familjen. Mund të jetë argëtues dhe edukues. Megjithatë, përdorimi i internetit përfshin gjithashtu rreziqe dhe sfida. Fëmijët pa e ditur mund të shpërndajnë informacione personale pa e kuptuar se mund t'i nënshtrohen vjedhjes së identitetit, ose të postojnë përmbajtje në rrjetet sociale që mund t'i bëjnë ata objekt të ngacmuesve kibernetikë. Në internet gjendet një gamë e gjërë informacioni dhe njohurish, duke bërë që fëmijët të mund të rrezikojnë e të ekspozohen ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme ose të padëshiruara që janë të pasigurta, të dhunshme ose të papërshtatshme për moshën e tyre.

Manuali për higjienën kibernetike është një set i udhëzimeve që i ndihmon fëmijët të mbajnë të dhënat e tyre në internet dhe pajisjet e tyre të sigurt dhe të mbrojtura nga kërcënime të mundshme të sigurisë, si dhe të monitorojnë aktivitetin e fëmijëve të tyre duke i mbrojtur nga ndonjë sulm i mundshëm kibernetik.

Përmbajtja

Parimet e sigurisë kibernetike

Faqja 3

Siguria e shëndetit tuaj

Faqja 4

Siguria në rrjetet sociale

Faqja 5

Identifikimi i çështjeve të sigurisë kibernetike

Faqja 6

Loja me vëndet boshe

Page 8

› Parimet e Sigurisë Kibernetike



☐ Përdor fjalëkalime të forta.

Fjalëkalimet e mia janë të vështira për t'u marrë me mend sepse përbëhen nga shkronja të mëdha dhe të vogla, numra dhe simbole.

Unë kurrë nuk i shpërndaj fjalëkalimet e mia me dikë tjetër përveç prindërve të mi, madje as me miqtë e mi më të mirë.



☐ Mendothem përpara se të shpërndaj.

Unë nuk shpërndaj informacione personale në internet, si p.sh. ku jetoj ose çfarë shkolle ndjek.

Unë kurrë nuk pranoj të takohem fizikisht me dikë që kam njohur në internet.



☐ Unë i dalloj falsifikimet.

Unë e kuptoj që njerëzit në internet nuk janë gjithmonë ata që thonë se janë.

Nëse një email ose një dritare pop-up duket e dyshimtë, unë nuk klikoj në asnjë link dhe e njoftoj menjëherë një të rritur.



☐ Unë nuk bëj ngacmime kibernetike.

Unë i trajtoj të tjerët në internet ashtu siç do të doja të më trajtonin.

Përpara se të postoj diçka në internet, pyes veten: "A është kjo diçka që ta them?"



☐ Kërkoj ndihmë kur kam nevojë.

Kur shoh diçka në internet që më bën të ndihem jo mirë, flas me një të rritur të cilit i besoj.

I tregoj një të rrituri për ngacmimin që ndodh në internet.

› Siguria e shëndetit tuaj

Informacioni për shëndetin tuaj është privat dhe duhet të mbahet i sigurt.



Jini të sigurt, jo social.

Informacioni për shëndetin tuaj, si sëmundjet fizike ose mendore dhe medikamentet, janë informacione private që duhet t'i ndani vetëm me mjekun tuaj dhe me prindërit ose kujdestarët tuaj.

Mos e shpërndani këtë informacion në internet ose në mediat sociale.



Mbroni historikun e shfletimit tuaj.

Sa herë që përdorni internetin për të hulumtuar një problem shëndetësor, aktivizoni gjithmonë shfletimin privat dhe përdorni softuer për bllokimin e reklamave për të parandaluar regjistrimin e të dhënave tuaja nga faqet ose shfletuesit e internetit.



Përdorni vetëm pajisje personale.

Mos përdorni një kompjuter publik ose pajisje tjetër (përfshirë atë në pronësi të shkollës suaj) për të hulumtuar mbi gjendjen tuaj shëndetësore ose për të hyrë tek të dhënat tuaja shëndetësore në internet.



Monitoroni aplikacionet dhe pajisjet.

Kontrolloni lejet dhe cilësimet e privatësisë sa herë që filloni të përdorni një aplikacion ose pajisje të re për të kufizuar përdorimin dhe shpërndarjen e të dhënave tuaja private.

> Siguria në rrjetet sociale

Ndiqui udhëzimet e mëposhtme për t'i mbajtur rrjetet sociale argëtuese dhe të sigurta



Shpërndani fjalëkalimet tuaja




Flisni me njerëz që nuk i njihni



Postoni vendndodhjen tuaj apo informacione private



Hapni linqe nga njerëz të huaj



Zgjidhni fjalëkalime të ndërlikuara



Kufizoni se kush mund t'i shohë postimet tuaja



Jini të sjellshëm me të tjerët



Postoni atë që ju bën krenar



> Identifikoni çështjet që lidhen me Sigurinë kibernetike

Identifikoni 5 problematika që lidhen me postimin e mëposhtëm



superstar_05

Shkolla "Jeronim de Rada"



Liked by albi and others

superstar_05 Erdhi pranvera!!



[View all 9 comments](#)

albi jam ana dhe po të shkuaj nga llogaria e albit!!! më merr në tel 0691234567 për detyrat!

unknown doni të fitoni \$200? **Më dërgoni mesazh për të marrë pjesë në konkurs!**

mel_online **pse duhet të jesh kaq i bezdisshëm???**

› Identifikimi i problematikave

Mos i përsërisni këto gabime

1. Asnjëherë mos postoni adresën e shtëpisë ose të shkollës ose emrin e shkollës suaj.



superstar_05

Shkolla "Jeronim de Rada"

2. Mos shpërndani fjalëkalimin tuaj me të tjerët

albi jam ana dhe po të shkuaj nga llogaria e **albit!!!**

3. Mos publikoni numrin tuaj të telefonit.

albi jam ana dhe po të shkuaj nga llogaria e albit!!! më merr në tel **0691234567** për detyrat!

4. Bëjini postimet të dukshme vetëm për njerëzit që njihni. Asnjëherë mos u bëni pjesë e konkurseve pa leje.

unknown doni të fitoni \$200? **Më dërgoni mesazh për të marrë pjesë në konkurs!**

5. Trajtojini të tjerët në internet ashtu siç dëshironi të trajtoheni. Nëse shihni ngacmime në internet, tregojini një të rrituri.

mel_online pse duhet të jesh kaq i bezdisshëm???

> Plotësoni

Plotësoni vendet boshe me fjalët më poshtë

pirateri

bullizues (ngacmues) kibernetik

virus

adresa

fjalëkalimi

sulm kibernetik

1

_____ është një kod sekret të cilin nuk duhet ta shpërndani dhe nuk duhet ta shkruani në asnjë vend

2

Nuk duhet të shpërndani asnjë informacion privat online, sic është numri juaj i telefonit, _____, ose shkolla.

3

Një _____ është dikush që ka qëllime të këqija ose është mosrespektues ndaj njerëzve të tjerë në internet.

4

Email-et ose tekstet që kanë gabime drejtshkrimore ose gramatikore dhe që përpiqen t'ju bëjnë të veproni shpejt pa u menduar mund të jenë _____.

5

Gjithmonë duhet të pyesni përpara se të shkarkoni ndonjë gjë në internet, pasi softueri falas mund të përmbajë _____.

6

Shkarkimi i paligjshëm i lojërave, filmave ose muzikës quhet _____. Konsiderohet vjedhje dhe mund t'ju fusë në telashe.